



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a

**Datë 19.12.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra**

**“Blerje lende djegese Pellet dhe Dru zjarri”.**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
09111220-8, 03413000-8

**VLERA E FONDIT LIMIT: 15,115,200 (pesëmbëdhjetë milion e njëqindë e pesëmbëdhjetë mijë e dyqindë ) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76 e 42, sipas të cilit:**

“Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon:

- a. çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b. studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

- c. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
- d. çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

**Komisioni organizoi punën** për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

#### **Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:**

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet

Grupi u mbeshtet: Në hetimin e tregut vendas si dhe nga investimet e mëparshme.

*Në Përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato në një Tabelë Komplekse të Grumbullimit të Zërave të mallrave bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se: Komisioni me unanimitet ; Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës;*

**Për një shumë prej 15,115,200 (pesëmbëdhjetë milion e njëqindë e pesëmbëdhjetë mijë e dyqindë ) lekë pa tvsh, Për prokurimin me titull :**

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. Formulari i Sigurimit të Ofertes sipas **Shtojces 4;** Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 302,304 (treqindë e dy mijë e treqindë e katër) lekë.

c. Formulari i Ofertes Ekonomike **Shtojca 1;**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertes, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (**2021, 2022, 2023**) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** *Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP të ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

*"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

**2.2.2** "Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2022, 2023**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen *edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese* Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

*Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

## **2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*vlera e pritshme e kontratave*) ose **6,046,080 (gjashtë milion e dyzetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë)** lekë pa tvsh. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë

duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca dhe fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre goftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetëdeklarimit se ka 1 (nje) mjet Kamioncine me vinc me kapacitet mbajtes jo më të vogël se 3 ton.

<i>Mjeti</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Mjet Kamioncine me vinc me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 3 ton.	1 copë	Pronësi ose me qera

**Ne cdo rast perpara publikimit te njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit, autoriteti enti kontraktor I kerkon ofertuesit te kualifikuar I pari, qe te dorezoje dokumentat provuese per vetëdeklarimet ne formularin permbledhes te vetëdeklarimit si me poshte:**

- a. Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetin e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa ”ç” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se furnizimi do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të furnizimit (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**2.3.3** Operatoret Ekonomike pjesëmarrës duhet te deklarojnë në fomrularin e vetedeklarimit se ka të punësuar minimalisht 4 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- 4 punonjes te thjeshte

**Ne cdo rast perpara publikimit te njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit, autoriteti enti kontraktor I kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, qe te dorezoje**

**dokumentat provuese per vetëdeklarimet ne formularin permbledhes te vetëdeklarimit si me poshte:**

1. Kontrata e punes (e vlefshme)

**Argumentimi:** per pikat 2.3.3 në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë,. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

**2.3.5/ Ofertuesi nepermjet nje deklarate duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin dhe shkarkimin e mallit prane AK.**

**Argumentimi:** nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Keiter i cili vleresohet i nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Të dhënat specifike për lenden djegëse “ Pellet” për ngrohje duhet të jenë si më poshtë:**

Nr	TREGUESIT	NJESIA	PARAMETRAT
1	Densiteti	Kg/m <sup>3</sup>	650
2	Fuqia Kalorifike	KW	4-4.2
3	Mbetja mbas djegjes	%	0.1-0.2
4	Permbajtja e squfurit	%	0.0025-0.0030

5	Amballazhimi	Thase	15 kg
6	Lageshtira	%	8.5-9.5
7	Dimensioni	mm	5-8
8	Gjatesia	mm	10-25

**Të dhënat specifike për lenden djegëse “ Dru zjarri” për ngrohje duhet të jenë si më poshtë:**

Të dhënat specifike për lëndën djegëse Dru duhet të jenë për kaldajë me fuqi 523 kë me dimesione 1.6\*2m.

Lënda djegëse duhet të jetë dru e stazhionuar që të japë fuqi kaloriferike sipas fuqise së kaldajës.

Lënda drusore duhet te jetë në përmasa të përshtatëshme për të furnizuar kaldajën dhe të jetë në masë të lehtë për ta përdorur specialisti për të furnizuar kaldajën.

*Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese është të kujdeset për ngrohjen e godinave të RSU Nr.1. Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi ka nevoja për pajisjen me lende djegese pellet dhe dru zjarri per te bere te mundur ngrohjen e Godinave. Produktet e kerkuara duhet të jenë sa më cilësore, ti përshtaten tërësisht specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

**Afatet e levrimit :**

Afati per dorezimin e mallit eshte 8 (tetë) muaj nga momenti i nënshkrimit te kontrates.

Furnizimi me pellet dhe dru zjarri do te behet ne magazinën dhe godinat e RSUNR.1 dhe UBT sipas grafikut te levrimit nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **13.01.2025, ora 12:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lende djegese pellet”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- Dokumentat e tenderit

**Njesia e prokurimit**